

**ADVISORY COMMITTEE ON THE
FRAMEWORK CONVENTION FOR THE
PROTECTION OF NATIONAL MINORITIES**

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

GVT/COM/III(2019)003

Albanian language version

**Comments of the Government of Montenegro on the Third Opinion of the Advisory
Committee on the implementation of the Framework Convention for the Protection of
National Minorities by Montenegro**

received on 31 July 2019



MALI I ZI
Ministria për të Drejtat e
Njeriut dhe Pakicave

Adresa: Bulevar Svetog PetraCetinjskog 130
81000 Podgorica, Crna Gora
tel: +382 20 234 193
fax: +382 20 234 198
www.minmanj.gov.me

**KOMENTET PËR MENDIMIN E TRETË TË KOMITETIT KËSHILLËDHËNËS
TË KONVENTËS KUADËR PËR MBROJTJEN E PAKICAVE KOMBËTARE**

Korrik, 2019.

Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave, si institucioni që koordinon hartimin e Raportit të tretë që lidhet me zbatimin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave, përshëndet mendimin që ka dhënë Komiteti Këshillëdhënës dhe ne na gëzon fryma konstruktive e bashkëpunimit që kemi pasur në periudhën e kaluar, e veçanërisht në prag të përgatitjes së Mendimit të Tretë lidhur me zbatimin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Mali i Zi respekton punën e Komitetit të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe të Komitetit të ekspertëve të Kartës Evropiane “Për gjuhët rajonale dhe të pakicave”, sepse rekomandimet e këtij organi, gjithsesi, janë një nga mekanizmat për përparimin, për sa i përket kësaj sfare, e gjendjes në terren.

Për ne, respektimi dhe përparimi i sferës së të drejtave të njeriut, dhe veçanërisht të drejtat e pakicave, përfaqësojnë një proces të vazhdueshëm, të cilit do ti përkushtohemi dhe paraprakisht gëzohemi për vazhdimin e këtij dialogu konstruktiv dhe mbetemi të hapur për bashkëpunim me Komitetin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, si edhe me organe të tjera të Këshillit të Evropës.

Në vijim gjenden disa rregullime dhe komente të institucioneve për Mendimin e Tretë të Komitetit Këshillëdhënës të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare:

11.(Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave)

Ligji për Ndalimin e Diskriminimit, pikërisht me nenin 2, dallon, midis të tjerave edhe bazën e diskriminimit në lidhje me ndonjë bashkësi të pakicës kombëtare, si dhe nëpërmjet sferave që rregullohen me këtë Ligj, dallohet edhe baza e lartpërmendur e diskriminimit.

Nga e gjithë kjo që përmendet më lart, mund të pohohet se diskriminimi i pjesëtarëve të pakicave dhe bashkësive të pakicave kombëtare njihet nga ky Ligj, si dhe sanksionohet në të gjitha sferat që rregullon ky Ligj.

36.(Ministria e Drejtësisë)

Me Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Penal të Malit të Zi ("G. Zyrtare e MZ", nr. 44/17) u krye ndryshimi i nenit 42a të KPMZ- Rrethana e veçantë për caktimin e dënimit për një vepër penale të kryer në bazë të urrejtjes.

47.a) (Ministria e Punëve të Brendshme)

Në raport me pikat nr. 47 dhe 48 të dokumentit, theksojmë se këto pika janë kontradiktore sepse nga pika 47 rezulton se bëhet fjalë për shtetasit e Republikës së Serbisë, kurse rekomandimi nga pika 48 lidhet me personat pa shtetësi.

b) (Ministria e Punëve të Brendshme)

Ne konsiderojmë se është fjala për persona që nuk mund të ekspozohen ndaj rrezikut të apatridit, sepse **në pikën nr. 47** thuhet, që këta persona kanë probleme me nxjerrjen e dokumenteve të udhëtimit të Republikës së Serbisë dhe konstatohet se ata kanë shtetësinë e Republikës së Serbisë, e prandaj Mali i zi nuk e ka mundësinë për të ndikuar që të përzihet në procedurat që janë parashikuar për nxjerrjen e dhënien e dokumenteve të udhëtimit në një shtet tjetër. Në bazë të Ligjit për të Huajt, që i huaji të realizojë një nga llojet e qëndrimit në Mal të Zi (qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm), duhet që, midis dëshmimeve të tjera, të ketë dokument udhëtimi të vlefshëm të shtetit të origjinës.

Në bazë të kësaj që u përmend më lart, personat e lindur në Republikat e ish RPFJ, RSFJ, RFJ dhe SMZ, nuk ka mundësi që të jenë persona pa shtetësi ose që fëmijët e tyre nuk e fitojnë shtetësinë në bazë të prejardhjes së prindërve, për shkak të rregulloreve juridike për shtetësinë e Republikave, domethënë shtetësinë federative e cika ka qenë e vlefshme.

Për sa i përket kushteve për fitimin e shtetësisë Malazeze, ato janë parashikuar në Ligjin për Shtetësinë Malazeze („G. Zyrtare e MZ nr. 13/08,40/10,28/11,46/11 dhe 20/14) dhe vlejnë pa përjashtime, për të gjithë paraqitësit e kërkesave për fitimin e shtetësisë Malazeze në bazë të një prej bazave të parashikuara, e përjashtim diskriminimin me çdo lloj baze (gjinisë, fesë, racës, ngjyrës së lëkurës ose të prejardhjes etnike), me principin e inkorporuar që duhet të përjashtohet apatridi. Gjithashtu, ky Ligj siguron barazinë midis shtetasve të tij, pavarësisht nëse shtetësinë Malazeze e fituan në bazë të prejardhjes ose me anë të pranimit.

48.(Ministria e Punëve të Brendshme)

Në rekomandimin numër 48, Këshilli Këshillëdhënës fton pushtetin që të gjejë zgjidhje, duke përfshirë edhe kanalet diplomatike, që tu sigurojë personave pa shtetësi një status juridik të përshtatshëm, i cili do tu mundësonte atyre qasjen ndaj të drejtave të tyre.

Në lidhje me këtë rekomandim theksojmë se përcaktimi i statusit dhe dhënia e dokumenteve të udhëtimit për personat pa shtetësi rregullohet me dispozitën e neneve 59 dhe 60 të Ligjit për të Huajt, dispozita me të cilat parashikohet që Ministria e Punëve të Brendshme, personave për të cilët në procesin e zhvilluar

përcaktohet se janë persona pa shtetësi, i jep personit pa shtetësi, në bazë të kërkesës së tij, dokument udhëtimi me afat skadimi një vitit.

Në bazë të dokumentit të udhëtimit që u jepet personave pa shtetësi, atyre mund tu jepet leja për qëndrim të përkohshëm, e kjo në rast se ka mjete për jetesë, ka banim të siguar, ka sigurim shëndetësor dhe që nuk ka ndalim hyrjeje dhe qëndrimi në Mal të Zi, me kushtin që, para se të paraqesë kërkesën, të banojë faktikisht në Mal të Zi të paktën tre vjet dhe që ka për qëllim që të vazhdojë të qëndrojë në Mal të Zi. Theksojmë se pas pesë vjetësh me qëndrim të miratuar, i huaji fiton të drejtën për qëndrim të përhershëm.

59.(Ministria e Punëve të Brendshme)

Nga gjithsej 145 persona, të cilët UNHCR i identifikoi si persona që kanë rrezik apatridi, dëshirojmë tu njohim, që ndërkohë, u përcaktua se 50 persona zotërojnë shtetësi të një shteti tjetër, që një person ka vdekur, që një personi i është dhënë dokumenti i udhëtimit për personat pa shtetësi, që për një person është në zhvillim e sipër procesi për dhënien e dokumentit të udhëtimit për persona pa shtetësi, që për dy persona është në zhvillim e sipër procesi për dhënien e shtetësisë Malazeze, që për 12 persona është nisur procesi jashtëgjyqësor për përcaktimin e vendit dhe datës së lindjes në territorin e Malit të Zi, për 10 persona është e nevojshme që të regjistrimin në librat e të lindurve në shtetin e prejardhjes, në mënyrë që të dorëzojnë kërkesat për marrjen e shtetësisë Malazeze (një nga prindërit është shtetas Malazez), që për 11 persona është e nevojshme të nisë procesi për regjistrimin në Librin e shtetasve të R. Serbisë / R. Kosovës (një nga prindërit është shtetas i këtyre shteteve), që 13 persona gjenden në listën e ekipit të lëvizshëm të MPB të Kosovës, kurse për 45 persona është nisur procesi i përcaktimit të vendit dhe datës së lindjes në territorin e Malit të Zi.

62.(Ministria e Punëve të Brendshme)

Theksojmë se MPB, për 56 persona nga lista e lartpërmendur, ka filluar verifikime në terren, e kjo për të përcaktuar nëse ata gjenden në Mal të Zi, ku mbas kryerjes së verifikimeve në terren për banimin e tyre, do ti njohë këta persona se si dhe në cilën mënyrë të zgjidhin çështjen e statusit të tyre, dhe në lidhje me këtë, e kjo në përputhje me dokumentet ligjore në fuqi, të paraqesin kërkesat përkatëse.

Duke pasur parasysh këtë që u përmend më lart, e kjo për shkak se UNHCR, nëpërmjet Qendrës Juridike, merret me punë në terren dhe ofrim të ndihmës këtyre personave që të bëjnë kërkesë për regjistrim të vonuar në regjistrin e të lindurve, i ftojme ata që të identifikojnë këta persona.

Ministria e punëve të brendshme është e përkushtuar që në çdo situatë konkrete që rezulton, të ofrojë ndihmë për të zgjidhur çështje të statusit të qytetarëve, e veçanërisht kur është në çështje regjistrimi i vonuar në regjistrat e të lindurve.

65. (Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave)

Fondi, i cili u riformua në vitin 2017 (me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave), financohet nga Buxheti i Malit të Zi me të paktën 0,15% të buxhetit në vijim (rreth një milion euro), dhe nga burime të tjera, në përputhje me Ligjin.

Fondi kryesisht ka shpallur konkurse publike dy herë në vit, kurse me rregullat e reja për administrimin e veprimtarinë e Fondit, nuk është parashikuar numri vjetor i shpalljeve të konkurseve publike.

Komisioni i vlerësimit, të cilin e përbëjnë shtatë specialistë të pavarur që i emëron Kuvendi i Malit të Zi, përcakton për këto shpallje përcakton nëse janë plotësuar kushtet e konkursit publik, bën vlerësimin, përcakton listën e radhitjes dhe përcakton propozimin për ndarjen e mjeteve financiare, në bazë të të cilës, Drejtori i Fondit merr vendimin për financimin.

66. (Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave)

Pakicës Serbe i janë akorduar më shumë mjete financiare, dhe pakicave Myslimane, Boshnjake, Shqiptare dhe Kroate u janë dhënë midis 10% dhe 17% të mjeteve, kurse pakica Rome ka përfituar nga 10 % në të dy ciklet.

Projekteve ndërkulturore ju janë dhënë rreth 36% të mjeteve financiare, gjë që përbën një rritje të ndjeshme nga viti 2017, kur ju dhanë rreth 4%. Projekteve që lidhen me pakicat Myslimane e Shqiptare u janë dhënë rreth 3% dhe 9% të mjeteve, kurse pakicës Serbe i është dhënë më pak. Projekteve të pakicës Rome u është dhënë rreth 8% të mjeteve në dispozicion, kurse pakicës Kroate i është dhënë 11%.

Fus nota nr. 56

Serbët: rreth një të tretën ose rreth 292.000 EUR, Romët: rreth 97.500 EUR;
Kroatët: rreth 97.000 EUR

Fusnota nr. 57

Myslimanët, Shqiptarët, Boshnjakët: rreth 125 000 deri 170 000 EUR (Myslimanët rreth 126.000 EUR, Shqiptarët rreth 157.000 EUR, Boshnjakët rreth 168.000 EUR)

Fusnota nr. 58

Romët: 97.400 EUR ose 10%

Fusnota nr. 59

Boshnjakët: 28% ose rreth 212 000 EUR.

Fusnota nr. 60

Projektet multikulturore të vitit 2018: afërsisht 273 000 EUR; të vitit 2017: 36 000 EUR afërsisht.

Fusnota nr. 61

Serbët: 5% ose rreth 39 000 EUR

Fusnota nr. 62

Romët: rreth 57 000 EUR; Kroatët: rreth 83 000 EUR.

68.(Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave)

Në vitin 2018. Fondi ka shpërndarë rreth 755.000 EUR (mjetet e destinuara për financimin e projekteve kanë qenë rreth 983.000 EUR, diferenca është kthyer në Buxhetin e Malit të Zi, sepse Komisioni për vlerësimin ka llogaritur se ka pasur një numër të pamjaftueshëm të projekteve (nga ata që nuk kënaqën kushtet formale juridike) që e merituan në bazë të cilësisë që të mbështeteshim nga ana financiare, dhe që u refuzuan ata që morën një numër të pamjaftueshëm të pikëve. Vlera mesatare e mbështetjes financiare të Fondit në vitin 2018 ka qenë 7.800 EUR për një projekt.

73. (Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave)

fusnota Pika 68.

Në vitin 2018. Fondi ka shpërndarë rreth 755.000 EUR

75.(Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave)

Në lidhje me pikën 75, pikën 188 dhe rekomandimin nr. 4, ku konstatohet se raportet dhe vlerësimet e projektit duhet të vihen në dispozicion të publikut, lutemi që diku të shtohet se që nga fundi i vitit 2015 në linkun <http://www.fzm.me/v/index.php/izvjestaji> mund të shihen për të gjithë përdoruesit e mjeteve financiare të Fondit të dhënat se si janë realizuar projektet, si dhe vlerësimet e raporteve financiare me shkrim, që nga themelimi i tij.

86.(Ministria e Kulturës)

Në Projektligjin e ri për Mediat dhe të Ligjit për shërbimet mediatike audiovizuale, janë radhitur këto rekomandime dhe se kompetenca për mbikëqyrjen dhe dhënien e sanksioneve i është dhënë Agjencisë për Mediat Elektronike. Për sa i përket mediave të printuara, gjuha e urrejtjes është në kompetencë të organeve vetërregulluese, të cilat ndjekin respektimin e kodit etik të gazetarëve.

94 – 97 (Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave)

Qeveria në mbledhjen e 121 që u mbajt më 16 Maj, miratoi Projektligjin për të Drejtat e besimeve ose bindje fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare. Është fjala për një akt juridik shumë të rëndësishëm, me të cilin përcaktohen çështje të rëndësishme të identitetit kulturor të Malit të Zi si shtet qytetar.

Çdo qytetari të Malit të Zi i garantohet liria që ti përkasë ose mos i përkasë ndonjë bashkësie fetare, përcaktohet e pronësia e shtetit mbi pasuritë kulturore që ka krijuar dhe ndërtuar shteti nëpër shekuj se siguron që Ligji të jetë i barabartë dhe i njëjtë për të gjitha bashkësitë fetare.

Projektligji që ka miratuar Qeveria më 16 Maj është harmonizuar me standardet më të larta ndërkombëtare, duke filluar nga Konventat e Kombeve të Bashkuara për këtë fushë, nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut me praktikën që e ndjek atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, deri tek Udhëzimet e Komisionit të Venecias dhe të OSBE/ODHIR nga viti 2004 dhe 2014.

Bëhet fjalë për një Ligj liberal, i cili siguron shkallën më të lartë të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar dhe një nivel shumë më të lartë të të drejtave dhe lirive sesa ligjet e tjera të këtij lloji në vendet që na rrethojnë.

Shteti me këtë Ligj siguron të drejtën e çdo qytetari të Malit të Zi të drejtën ti përkasë ose jo një bashkësie të përcaktuar fetare. Pra, Shteti mbron edhe ata që janë besimtarë, duke ju dhënë liri të madhe për të shprehur të drejtën e tyre për të besuar, si dhe atyre që nuk janë të tillë, të cilëve ju garanton gjithashtu

të mos jenë besimtarë. Nga ky Ligj rezulton qartë se në Malin e Zi, si shtet qytetar, nuk ekziston fe shtetërore.

Me këtë akt ligjor në Mal të Zi për herë të parë rregullohen një sërë çështjesh të rëndësishme. Një nga këto çështje është çështja e hapësirës së veprimit të këtij Ligji. Me këtë ligj përcaktohet mjaft qartë se deri ku shtrihen të drejtat dhe detyrimet e bashkësive fetare. Pra nuk do të jetë e mundur që një bashkësi fetare të gëzojë të drejta në territorin e Malit të Zi, dhe të mbetet jashtë fushës së veprimit të ligjeve të Shtetit të Malit të Zi.

Gjithashtu, me të rregullohet procedura e regjistrimit, si dhe evidenca e bashkësive fetare. Standardi juridik ndërkombëtar përcakton që shteti do të lejojë veprimtarinë fetare edhe bashkësive fetare që nuk janë të regjistruara.

Për këtë arsye, është çështje e vullnetit të lirë të bashkësisë fetare, nëse do të regjistrohet ose jo. Por, bashkësia fetare, që nuk dëshiron të regjistrohet, dhe që të cilës i janë dhënë mundësitë për ta bërë këtë gjë, nuk do të ketë të njëjtin status si ai që kanë ato bashkësi fetare që, me shprehjen e vullnetit të lirë, regjistrohen. Pra, edhe bashkësitë e paregjistruara mund të veprojnë, por bashkësi të tilla të paregjistruara nuk mund të përfitojnë lehtësi tatimore.

Pastaj, me këtë Ligj zgjidhet në mënyrë të qartë dhe transparente çështja e pronës shtetërore. Të gjitha objektet fetare që kanë qenë pronë e Shtetit të Malit të Zi para humbjes së pavarësisë dhe aneksimit nga Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve në vitin 1918, të cilët nuk kaluan më vonë në mënyrë të përshtatshme juridike në pronë të ndonjë bashkësie fetare, do të njihen si pronë shtetërore. Por, në rast se ndonjë bashkësi fetare disponon dëshmi që është bërë pronare e ndonjë prone, në bazë të akteve ligjore në fuqi në të shkuarën ose në kohën e sotme, Shteti këtë gjë do ta pranojë e respektojë. Atje ku nuk ekzistojnë dëshmi të tilla, por është fjalë për prona që i ka krijuar dhe blerë Shteti i Malit të Zi dhe të cilat përfaqësojnë pasuri kulturore të të gjithë qytetarëve të vet, kjo lloj prone, si pasuri kulturore, do të regjistrohet si pronë shtetërore e Malit të Zi.

Më tej, me këtë Ligj rregullohet edhe arsimimi fetar. Bashkësitë fetare do të kenë mundësi për të themeluar shkolla në të gjitha nivelet e arsimimit, përveç shkollave fillore. Qeveria konsideron se në këtë nivel, fëmijët nga 6 vjeç e lart nuk duhet të ndahen, që fëmijët në shkollat shtetërore duhet të ndjekin të njëjtin program mësimor, duke u nisur nga fakti se shkolla fillore sipas Kushtetutës dhe Ligjit është e detyrueshme, e prandaj është detyrë e shtetit si ligjvënës, që ta rregullojë kështu edhe këtë çështje. Qeveria nuk ra dakord as me kërkesat që në shkollat shtetërore të futet edukimi fetar. Edukimi fetar është i lirë, mësimi i besimit është i lirë në të gjitha nivelet, por qëndrimi i Qeverisë është që ai nuk duhet të ketë vend në shkollat shtetërore. Edhe shtetet që na rrethojnë, të cilat u përpoqën për të futur edukimin fetar në shkollat shtetërore nuk patën sukses dhe nuk mund të krenohen që kjo eksperiencë çoi më lart cilësinë e arsimimit publik dhe të unitetit, tolerancës dhe harmonisë shoqërore. Me këtë gjë nuk ngushtohet aspak e drejta e prindërve për të arsimuar fëmijët në përputhje me besimet e tyre fetare dhe bindjeve të tjera.

Pra, duke propozimin e këtij teksti ligjor, Qeveria përmbush detyrimin e vet kushtetues dhe ndaj të drejtës ndërkombëtare, dhe në të njëjtin kuptim edhe atë historik, që çështjet e lirisë së besimit fetar në Mal të Zi ti rregullojë me një Ligj modern, sipas standardeve më të larta ndërkombëtare.

Ky Projektligj çdo qytetari të Malit të Zi i garanton lirinë që, në bazë të ndërgjegjes së tij, të jetë ose të mos jetë besimtar i çdo lloji besimi fetar, e këtu Shteti mbron pronën dhe pasurinë kulturore që i përket të gjithë qytetarëve dhe siguron që Ligjet e Malit të Zi vlejnë njësoj për të gjithë, në të gjithë territorin e Shtetit tonë.

Për arsye të rëndësisë së këtij dokumenti juridik, i cili përcakton çështjen e rëndësishme të identitetit të qytetarëve Malazezë, dhe të harmonizimit të tij me standardet më të larta ndërkombëtare, Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave ftoi anëtarët e Komisionit të Venecias që të vizitojnë Malin e Zi.

Vizita e Komisionit të Venecias në Mal të Zi ishte rast për të prezantuar Projektligjin edhe shkëmbimin e mendimeve në këtë temë me bashkëbisedues të rëndësishëm. Gjithashtu, Ministria e ftoi Komisionin e Venecias që të dorëzonte mendimin për Projektligjin për Lirinë e besimit dhe bindjeve fetare dhe të pozicionit juridik të bashkësive fetare, gjë që Komisioni i Venecias e realizoi.

Miratimi i mendimit të Komisionit të Venecias në Seancën plenare të 119-ë, e cila është mbajtur më 21 dhe 22 Qershor 2019, është vetëm hapi i parë në procedurën e miratimit në Kuvendin e Malit të Zi të Projektligjit për Lirinë e besimit dhe bindjeve fetare dhe të pozicionit juridik të bashkësive fetare në Mal të Zi.

102.(Ministria e kulturës)

Në Projektligjin për Mediat është përcaktuar Fondi për Pluralizëm dhe Shumëllojshmëri të Mediave. Qasje ndaj Fondit do të kenë si mediat komerciale, ashtu edhe ato jo me fitim. Mjetet financiare do të akordohen me anë të financimit të projekteve, dhe janë të destinuara për shërbime publike, pra për përmbajtje me interes publik në këto medie.

103.(Ministria e kulturës)

Qëndrueshmëria e shërbimeve publike është përcaktuar me Ligjin aktual për Mediat Elektronike, i cili parashikon që themeluesit e emetuesve publikë të vetëadministrimit lokal, financojnë me kontratë shërbimet publike të emetuesve publikë. Ndërmjet këtyre shërbimeve janë përmbajtjet e detyrueshme në gjuhët e pakicave.

105.(Ministria e kulturës)

Në Projektin e Ligjit për Mediat, dispozitat që lidhen me korrigjimet dhe përgjigjet janë në harmoni me rekomandimet e KE-së dhe të analizës së Sektorit të mediave në Mal të Zi (JUFREX). Është parashikuar edhe që organet e besueshme vetërregulluese të financohen nga Fondi për Pluralizmin dhe Shumëllojshmërinë e Mediave, e me këtë gjë të sigurohet qëndrueshmëria e tyre, si edhe të sigurohet që të respektohen standardet.